


Bibël për fëmijët
paraqet



Elizeu,
Njeriu i
Mrekullive



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Lazarus

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children

www.M1914.org

©2013 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.



Nuk kishte
mjaftueshëm
qe për të tërhequr
plugun.



Nevojitej edhe një
tjetër. Kjo nuk e
pengoi një fermer
të ri të quajtur
Elize!



Thjesht ai u vu nën
të njëjtën barrë me
qetë, dhe zëvendësoi
atë që mungonte.



Ai duhej te kishte
qenë një burrë i
fortë, i zgjuar dhe
shumë puntor.






Ndërsa Elizeu
po plugonte,
Elia profeti i
Perëndisë, e
thirri atë.





Burri i ri e
la fermën e tij
për tu bërë
shërbëtori i
Perëndisë.






Një ditë,
Perëndia e mori
Elian në qiell, në
një vurbull ere.



Tani Elizeu
ishte profeti i
Perëndisë për
Izraelin.






Megjithëse Elizeu
ishte i trishtuar sepse
Elia kish shkuar, ai u
lut që Perëndia do

ti jepte atij
fuqi si Elias.



A colorful illustration of a landscape. In the foreground, there is a large white bird with its wings spread, perched on a patch of green grass. To the left, a yellow cloth is draped over a brown, rocky mound. Further left, a red cloth is draped over another mound. In the background, there is a large green tree with a brown trunk. The sky is a solid blue color. The overall style is simple and cartoonish.

Elizeu mori mantelin
e Elias dhe goditi
ujrat e rrjedhshëm
ashtu si Elia

kishte
bërë.



Ujërat u ndanë!
Tani Elizeu e dinte
që Perëndia ishte
me të.





Ndërsa Elizeu
po shkante në
një vend të
quajtur Bethel,
disa të rinj e
tallën, duke i
thirrur,
“Ngjitu, ngjitu
kokëtullac”!





Ata nuk donin
t'ia dinin se
Elizeu ishte
shërbëtori i
Perëndisë.
Një gjë e
tmerrshme u
ndodhi atyre.







Dy arusha
dolën nga
pylli dhe
sthrinë të
vdekur dyzet
e dy vetë nga
ata.




Një ditë
Elizeu, takoi
një grua të
ve e cila
kishte një
borxhqë
nuk po e
paguante
dot.




Për të marrë
paratë e tij,
huadhënësi
vendosi të
marrë si
sklevër dy
djemtë e
vejushës.




"Shko merr
hua enë nga
të gjithë
fqinjët e
tu... enë
bosh", i tha
Elia asaj.




Perëndia do të bënte diçka të
mrekullueshme
për atë
grua.



Vejusha kishte vetëm një vazo të vogël vaji në shtëpi. Por nga ai pak vaj ajo mbushi aq shumë vaj, sa të gjitha enët e marra hua u mbushën!



Nëse do kish vaska në atë kohë,
a do ti mbushte edhe ato me vaj
Perëndia? Si mendoni? Gruaja e
ve, shiti vajin dhe
pagoi borxhin
duke shpëtuar
kështu bijtë
e saj.



Një grua tjetër dhe bashkëshorti i saj, i bënë Elizeut një dhomë të veçantë në shtëpinë e tyre, që ai të rrinte aty sa herë kalonte andej.




Në dhomë ata vendosën
një shtrat, një tryezë,
një karrige
dhe një
shandan.


Ajo dhomë
ishte gjithnjë
e rezervuar
për Elizeun.




Elizeu mendohej si mundej ta shprehte mirënjohjen për mirësinë e këtij çifti. Kur ai mësoi se ata nuk kishin fëmijë, ai tha diçka që gruaja me zor mund ta besonte.




"Si në k'të kohë vitin tjetër, ti do përqafosh një bir". Dhe pikërisht sipas këtij premtimi, fëmija lindi.




Disa vite më vonë i njëjti fëmijë
ishte në fushë me babain e tij. "O
koka ime, koka ime", bërtiti djali.



Kur ata e sollën tek mamaja e tij,
ai u ul në prehërin e saj gjer në
mesditë dhe pastaj vdiq.



Mamaja e vendosi djalin në shtrat
në dhomën e Elizeut. Kush mendoni
ju se mund ta ndihmonte atë?



A mos the gjë ti, Elizeu? Po e
vërtetë! Ajo shaloi një gomar dhe
me shpejtësi të
madhe shkoi ta
gjejë atë.



Elizeu erdhi në shtëpinë e saj, shkoi
vetëm në dhomën e sipërme dhe iu
lut Perëndisë.



Perëndia e ngjalli çunin e vogël prej
së vdekurish.



Elizeu thirri gruan dhe i tha, "Merre djalin tënd". O sa e lumtur që ndihej ajo grua!



Në vendin e afërm
të Sirisë, jetonte
një komandant
ushtrie që quhej
Naman.



Ai ishte trim dhe
i fortë, por kishte
një sëmundje të
tmerrshme lëkure,
të quajtur lebër.




Gruaja e Namanit
kishte një vajzë të
vogël shërbëtore
nga Izraeli.



Kjo vajzë e vogël
tha, "Ah sikur vetëm
të ishte Namani me
profetin që është
në Izrael! Sepse
ai mund ta
shëronte atë
nga lebra".



Namani u nis menjëherë për të parë profetin. Ai mori me vete argjend, ar dhe rroba të bukura për dhuratë.





Shërbëtori i Elizeut
doli tek dera
dhe tha, "Shko,
zhytu në lumin
Jordan shtatë
herë dhe do të
pastrohesh".
Namani u
tërbua fare.





A nuk mund
të zhytej ai
në lumenjtë
e pastër dhe
të freskët
të vendit të
tij, Sirisë?





Shumë
i zemëruar,
ai u kthye
rrëmbimthi
dhe u nis të
kthehej në
shtëpi.





Për fat të mirë,
shërbëtorët
e tij i thanë
që ti bindej
urdhërit të
Elizeut.





Kështu Namani
zbriti poshtë
në lumë dhe u
zhyt shtatë
herë në
Jordan.



Dhe Namani
lebrozi u
shërua.





Pas kësaj
Namani adhuroi
Perëndinë e
vërtetë,
Perëndinë e
Elizeut,
PERËNDINË
i Cili e kishte
shëruar nga lebra.





Perëndia
e përdori
shërbëtorin
e tij, Elizeun,
edhe pasi ai
kish vdekur.





Një ditë,
varrosën
një njeri në
varrin ku
përpara
ishte
varrosur
Elizeu.





Kur trupi
i vdekur i
njeriut
preku kockat
e profetit,
njeriu u
ringjall duke
u ngritur
në këmbë.





Perëndia
tregoi fuqinë
e Tij të
madhërishme,
nëpërmjet
shërbëtorit
të Tij, Elize.



Elizeu, Njeriu i Mrekullive

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Mbretërve 2-13

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëj atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.



Nëse ti beson se kjo është e
vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i
bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia,
dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në
jetën time dhe fal mëkatet e mia, në mënyrë
që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem
me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem
dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë
çdo ditë! Gjoni 3:16

